

01 tetor 2014

KOMUNIKATË PËR MEDIA Të rinjtë nuk pyeten për kërkesat e tyre

EC Ma Ndryshe sot ka vijuar debatin e katërt me rradhë në kuadër të ciklit të debateve "Planifikim urban me pjesëmarrje". Qëllimi i këtyre debateve është prezantimi i të gjeturave të fokus grupeve me shtatë grupe të komunitetit në Prizren për identifikimin e problemeve dhe përkthimin e kërkesave të tyre në plane konkrete për adresim në insitucionet përgjegjëse.

Panelist i këtij debati ishte z.Kreshnik Basha nga Caritasi Zviceran, ndërsa pjesë aktive e këtij debati ishin edhe asambleistë, drejtues të insitucioneve shkollore dhe përfaqësues të OJQ-ve që merren me të drejtat e të rinjëve. Debati u shoqërua me pjesëmarrje aktive në diskutim të nxënësve të shkollave fillore dhe të mesme, arkitektë, atistë e urbanistë të rinjë.

Fillimisht në këtë debat u prezentuan të gjeturat kryesore nga dy fokus grupet e mbajtura me komunitetin e të rinjëve, problemet dhe kërkesat e dalura nga këto diskutime si dhe të gjeturat e dalura nga raporti i vitit të kaluar në kuadër të projektit "Qyteti Gjithëpërfshirës". Para të pranishmëve u prezentuan edhe rezultatet nga anketa e fundit me 400 responentë në Prizren mbi perceptimin e qytetarëve për planifikimin urban. Në të gjeturat kryesore nga anketa me qytetarë rezulton të jetë mos informimi i tyre për ekzistimin e planeve urbane në qytetin e Prizrenit dhe mos pjesëmarrja e tyre në debate publike.

Se u takon të marrin pjesë aktive në debatet publike lidhur me planet urbane, nuk kishin njohuri as të rinjtë e pranishëm në këtë debat. Të pytur nëse janë pyetur ndonjëherë për ato që u shqetëson, të rinjtë e grupmoshave të fëmijërisë së hershme kanë hezituuar të përgjigjen. Ndër të tjera është vënë në pah mosnjohuria e tyre e përgjithshme lidhur me procesin e urbanizmin në tërësi dhe vlerat e trashëgimisë kulturore ne veçanti. Debati ka nxjerr në pah nevojën enorme të përfshirjes së lëndëve mësimore të cilat do të reflektonin te të rinjtë njohuritë e përgjithshme lidhur me vizionin e qyteteve të së ardhmës dhe fushatave tjera sensibilizuese për nxitjen e pjesëmarrjes aktive të të rinjëve në planifikimin urban. Të rinjtë pjesëmarrës u inkurajuan të bëhen më të zëshëm për kërkesat dhe shqetësimet e tyre!

Cikli i debateve do të vazhdojë me debatin e rradhës "Banorët e lagjes Tusuz dhe planifikimi urban", që mbahet më 08 tetor 2014 në Prizren.

Me respekt, Flaka Xërxa, koordinatore projekti
OJQ EC Ma Ndryshe
Rr.Saraqët 5, 20000 Prizren
+381 38 224 967 & +381 29 222 771
www.ecmandryshe.org & info@ecmandryshe.org
xerxa.flaka@ecmandryshe.org

Projekti "Qyteti gjithëpërfshirës – planifikimi me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren" përkrahet financiarisht nga Olof Palme International Center që përkrahet nga Qeveria e Suedisë

